



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.77/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Koalicionit PAI- PDAK-LPB, paraqitur ndaj vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 03.02.2026, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.77/2026, e datës 02.02.2026, e parashtruar nga Koalicionit PAI- PDAK-LPB, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 02.02.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën ZP.Anr.77/2026, nga Koalicionit PAI- PDAK-LPB, në të cilën thekson se bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.08/228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, thuhet: *Te dhënat dhe rezultatet për çdo vendvotim dërgohen për tabulim në QNR, menjëherë pas përfundimit të punës së çdo ndërrimi. Kopjet e formularëve të rezultateve skanohen, publikohen dhe vendosen në vende të qasshme për vëzhguesit, si dhe ju ofrohen subjekteve politike dhe kandidatëve, sipas kërkesës, dhe në nenin 105 paragrafit 1. Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar*”, Koalicioni PAI - PDAK – LPB, thekson se duke e kuptuar që KQZ ka shmangur disa nga procedurat e administrimit të numërimit dhe rinumërimit të votave të 28 dhjetorit 2025 kërkon nga PZAP: Rinumërim për subjektet politike të komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian, anulimin e votave për subjektet politike nga Komunitetet Ashkali dhe Egjiptian në vendbanimet ku nuk ka pjesëtarë të komuniteteve të tyre në ato komuna, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të ASK-së, ri përsëritjen e zgjedhjeve në komunat ku ka pjesëtarë të Komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian. Tutje në ankesë theksohet se fillimisht KQZ mori vendim në kundërshtim me ligjin për zgjedhjet, tani KQZ ka ndryshuar metodologjinë e numërimit dhe rinumërimit në mes të procesit, duke braktisur rendin sipas komunave dhe vendvotimeve, dhe duke e zëvendësuar me

një proces kaotik, të fragmentuar. Po ashtu në ankese ceket se ky ndryshim arbitrar ka prodhuar devijim të qartë të trendit të rezultateve dhe ka dëmtuar rend besimin e subjekteve politike dhe kandidatëve. Kur rinumërimi ndërpritet pa kriter, vazhdohet me komuna të tjera dhe humbet gjurmshmeria e vendvotimeve, procesi behët i pa besueshëm. KQZ në vend që të mbroj integritetin e votës, po ndryshon rregullat gjatë numërimit dhe rinumërimit, duke u shndërruar nga arbitër i pa anshëm, në palë aktive në deformimin e procesit zgjedhor. Pala ankuese kërkon rikthimin e menjëhershëm, rinumërimin për subjektet politike të komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian, anulimin e votave për subjektet politike nga Komunitetet Ashkali dhe Egjiptian në vendbanimet ku nuk ka pjesëtarë të Komuniteteve të tyre në ato komuna, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë ose Ri përsëritjen e zgjedhjeve në komunat ku ka pjesëtarë të Komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian si në komunat: Pejë, Prizren, Podujevë, Prishtinë Suharekë, Gjakovë, Mitrovicë Jugore, Istog, Klinë, Lipjan, Shtime, Ferizaj, Fushë Kosovë, Rahovec, dhe Vushtri. Gjithashtu në ankesë theksohet se rezultati i ngushtë mes koalicionit PAI — PDAK - LPB dhe PSA prej 54 votave ku ne kemi dyshimin tonë që është favorizuar në disa komuna PSA pasi që kjo iniciativë udhëhiqet nga ish Anëtari i KQZ-së, Arton Asllani dhe i afërt me pushtetin besojmë që është manipuluar procesi i rezultateve të zgjedhjeve për vendet e komunitetit Ashkali dhe Egjiptian, dhe se bazuar në Kushtetutën e Kosovës nenit 64 garojmë për vende të garantuar, dhe kemi vendime të Gjykatës Supreme dhe Gj. Kushtetutës që deputetet e komuniteteve duhet të zgjedhën nga votat legjitime të qytetarëve nga pakicat, andaj pasi kemi një rezultat të ngushtë duhet të anulohen mbi 350 vota të subjektit PSA që kanë marrë në Komuna ku nuk ka pjesëtarë të Komunitetit Ashkali dhe duhet të anulohen mbi 1300 vota të subjekteve nga komuniteti Egjiptian, që kanë marrë në ato komuna që nuk ka pjesëtarë të këtij komuniteti. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës numrin e popullsisë të komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian dhe numrin e votave në çdo komunë për subjektet politike të tyre .

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, lidhur me pretendimet e palës ankuese ka theksuar se, procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Krahës fletëvotimeve, në ekran është prezantuar edhe pamja e sistemit elektronik ku figurojnë numrat e kandidatëve të cilët regjistrohen në sistem. Pra pretendimet e palës ankuese se KQZ ka ndryshuar metodologjinë e numërimit dhe rinumërimit në mes të procesit, nuk qëndrojnë, sepse KQZ ka vepruar në përputhshmëri të plotë me Rregulloren e lartcekur, si dhe me procedurat e miratuara nga KQZ. Gjithashtu, procesi i rinumërimit është zhvilluar për të gjitha vendvotimet në të gjithë Republikën e Kosovës, duke përfshirë këtu edhe komunat në të cilat janë të përfshira edhe komunitetet të cilat pala i ka përmendur në ankesë. Lidhur me kërkesën e palës ankuese për anulimin e votave të komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian në vendbanimet ku nuk ka pjesëtar të komuniteteve në ato Komuna, KQZ ju njofton se liria dhe e drejta e votës në Republikën e Kosovës janë të garantuara me Kushtetutë dhe me ligjet që rregullojnë proceset zgjedhore, Këto të drejta bazohen në Parimin e barazisë së qytetarëve dhe komuniteteve, që është një nga shtyllat themelore të rendit kushtetues të Kosovës.

Paragrafi 1 i nenit 45 së Kushtetutës së Republikës së Kosovës thotë: *Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhët, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.* Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh: *Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e*

fshehtë. Dispozitat e lartcekura janë të përfshira edhe në nenin 6 paragrafin 1 dhe 2 të LZP-së. Përkatësisht, as Kushtetuta e as Ligji për Zgjedhjet nuk i ndalon votuesit me përkatësi etnike të ndryshme të votojnë në vendvotime, konkretisht Kosova nuk është e ndarë në zona zgjedhore ku votohet sipas përkatësisë etnike, Gjithashtu, në bazë të këtyre dispozitave, nuk mund të paragjykohe mënyra e zgjedhjes së votuesit për një subjekt të caktuar politik.

Kërkesa e palës ankuese për shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve, nuk qëndron, për shkak se ajo duhet të jetë e bazuar dhe të ketë mbështetje ligjore, e as nuk mund të shpallet fletëvotimi i pavlefshëm në bazë të përkatësisë etnike të votuesit. Rastet e shpalljes së fletëvotimit të pavlefshëm parashihen në paragrafin 2.2 të nenit 16 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 Votimi, Numërimi Në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit. Gjithashtu, në procedurat e votimit dhe numërimit në vendvotim, të miratuar nga KQZ me datë 04.12.2025, nr. 01/3631/2025 për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, janë paraparë shembujt e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme. Pretendimet e palës ankuese nuk qëndrojnë sepse në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit e as përkatësia etnike e votuesit. Përmbajtja dhe përshkrimi i fletëvotimit parashihet në nenin 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 10/2024 për Fletëvotimet dhe Broshurat.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Paneli ka vlerësuar pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës, e i cili pretendon se, ka pasur parregullsi gjatë procesit të numërimit dhe rinumërimit nga KQZ, dhe se rezultati i ngushtë mes koalicionit PAI - PDAK - LPB dhe PSA prej 54 votave, për të cilin kanë dyshime që është favorizuar në disa komuna PSA dhe është manipuluar procesi i rezultateve të zgjedhjeve për vendet e komunitetit Ashkali dhe Egjiptian, dhe që deputetet e komuniteteve duhet të zgjedhën nga votat legjitime të qytetarëve nga pakicat, andaj, pasi kemi një rezultat të ngushtë duhet të anulohen mbi 350 vota të subjektit PSA që kanë marrë në Komunë ku nuk ka pjesëtarë të Komunitetit Ashkali dhe duhet të anulohen mbi 1300 vota të subjekteve nga komuniteti Egjiptian, që kanë marrë në ato komuna që nuk ka pjesëtarë të këtij komuniteti, për Panelin këto pretendime ankimore janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj.

Nga pretendimet theksuara në ankesë paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pretendon pala ankuese, kjo pasi që ankuesi në ankesën e tij nuk i ka bashkangjitur asnjë provë të vetme dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e tij dhe se pretendime të theksuara në ankesë tani për tani mbeten në nivel të supozimit nga se nuk janë argumentuar me fakte dhe prova konkrete.

Paneli vlerëson se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për faktin se nuk mund të vërtetohet se ka pasur manipulime të votave gjegjësisht se në disa komuna është favorizuar PSA, ashtu siç pretendon pala ankuese, kjo pasi që Paneli nuk mundi të vërtetoj një pretendim të tillë për faktin se pala ankuese pretendimet e saj nuk i ka mbështetur me asnjë provë të vetme dhe se pritshmëritë e ankuesit nuk nënkupton se automatikisht subjekti politik kishte me marrë vota më shumë.

Paneli vlerëson se sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnicitetin e votuesve përkatësisht të votimit. Andaj për Panelin këto

pretendime janë të pabazuara duke iu referuar nenit 6 par. 2 i LZP-së, që parasheh se “Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë”, duke mos paragjykuar se si një votues zgjedhë të votojë një subjekt politik të caktuar”.

Paneli në rastin konkret i është referuar Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI69/2021 në pikën 196 ku në mënyrë decisive është theksuar se: “... në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë bazë mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaroi që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Gjykata rikujton që sipas GJENDJ-së (i) nuk është detyrë e gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve, përfshirë përmes shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë dhe (ii) çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullativa e KQZ-së. në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime.” Ndërsa në pikën 198 të këtij aktgjykimi është konstatuar se: “Përfundimisht, Gjykata rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit.”

Po ashtu paneli ka marrë për bazë dispozitën e nenit 45.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku është paraparë që: “Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh që: ”Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.” Në rastin konkret, Paneli vlerëson se nuk mund të pranohet një pretendim apo kërkesë e tillë që synon rinumërimin e votave për subjektet politike të komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian, anulimin e votave të dhëna për këto subjekte në vendbanimet ku, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, nuk ka pjesëtarë të këtyre komuniteteve në komunat përkatëse, apo përsëritjen e zgjedhjeve në komunat ku ka pjesëtarë të komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian.

Paneli rithekson se, në përputhje me parimet kushtetuese dhe legjislationin në fuqi, vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Si e tillë, ajo nuk mund të anulohet apo të shpallet e pavlefshme mbi bazën e përkatësisë etnike të votuesit. As Ligji dhe as Rregulloret e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk parashohin ndonjë kriter tjetër mbi bazën e të cilit fletëvotimet mund të shpallen të pavlefshme, e aq më pak një kriter që lidhet me përkatësinë etnike të votuesve.

Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga koalicioni PAI - PDAK - LPB, është e pabazuar pasi që nuk ka bashkangjitur prova bindëse që do të dëshmonte pretendimet ankimore. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”. Andaj, Paneli e refuzoi ankesën pasi që pala ankuese nuk e bëri të besueshme me prova bindëse dhe nuk ka mundur të vërtetojë se është manipuluar procesi i rezultateve të zgjedhjeve për vendet e komunitetit Ashkali dhe Egjiptian, por se theksimet e saj në ankesë janë parashtruar në aspektin deklarativ pa qene të mbështetura në prova dhe të paargumentuara me fakte,.

Andaj nga arsyet e theksuara si më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZP.Anr.77/2026 më datën 03.02.2026



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.7/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Bajrami, kryetar, Milena Djerić dhe Delushe Halimi, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së Koalicionit PAI-PDAK-LPB, për shkak të parregullsive në shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.77/2026, të datës 03.02.2026, në seancën e mbajtur më datë 09.02.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Koalicionit PAI- PDAK-LPB, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZP.Anr.77/2026, të datës 03.02.2026.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ZP.Anr.77/2026, të datës 03.02.2026, është vendosur: "REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.77/2026, e datës 02.02.2026, e parashtruar nga Koalicionit PAI- PDAK-LPB, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025".

Kundër vendimit të lartpërmendur, Koalicioni PAI-PDAK-LPB, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke pretenduar se PZAP ka keqinterpretuar objektin dhe përmbajtjen e ankesës, duke bërë kështu zbatim të gabuar dhe selektiv të Aktgjykimit KI69/2021 të Gjykatës Kushtetuese, ka shkelur parimin e hetimit efektiv dhe proporcionalitetit, si dhe ka cenuar parimin e besimit publik dhe sigurisë juridike në procesin zgjedhor, duke propozuar që Gjykata Supreme të aprovojë ankesën e Koalicionit PAI- PDAK-LPB, të shfuqizoj vendimin e PZAP-së, nr. ZP.Anr.77/2026, si dhe ta kthej çështjen për rishqyrtim me udhëzim për rinumërim të plotë, të pavarur dhe transparent të të gjitha votave (kutive të vendvotimeve në Kosovë dhe diasporës), ose të anulohen votat në vendbanimet (komunat) ku nuk ka pjesëtarë të komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian, si dhe të bëjë zhvillim të hetimit procedural të procesit të numërimit dhe rinumërimit, dhe alternativisht të ndërmerren masa korrigjuese për garantimin e integritetit të procesit zgjedhor.



PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të Koalicionit PAI- PDAK-LPB, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e Koalicionit PAI- PDAK-LPB, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi i ankimuar i PZAP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Me datë 02.02.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën ZP.Anr.77/2026, nga Koalicionit PAIPDAK-LPB, në të cilën thekson se bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.08/228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, thuhet: Të dhënat dhe rezultatet për çdo vendvotim dërgohen për tabulim në QNR, menjëherë pas përfundimit të punës së çdo ndërrimi. Kopjet e formularëve të rezultateve skanohen, publikohen dhe vendosen në vende të qasshme për vëzhguesit, si dhe ju ofrohen subjekteve politike dhe kandidatëve, sipas kërkesës, dhe në nenin 105 paragrafit 1. Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe ONR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar", Koalicioni PAI - PDAK – LPB, thekson se duke e kuptuar që KQZ ka shmangur disa nga procedurat e administrimit të numërimit dhe rinumërimit të votave të 28 dhjetorit 2025 kërkon nga PZAP: Rinumërim për subjektet politike të komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian, anulimin e votave për subjektet politike nga Komunitetet Ashkali dhe Egjiptian në vendbanimet ku nuk ka pjesëtarë të komuniteteve të tyre në ato komuna, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të ASK-së, ri përsëritjen e zgjedhjeve në komunat ku ka pjesëtarë të Komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian. Tutje në ankesë theksohet se fillimisht KQZ mori vendim në kundërshtim me ligjin për zgjedhjet, tani KQZ ka ndryshuar metodologjinë e numërimit dhe rinumërimit në mes të procesit, duke braktisur rendin sipas komunave dhe vendvotimeve, dhe duke e zëvendësuar me një proces kaotik, të fragmentuar. Po ashtu në ankesë ceket se ky ndryshim arbitrar ka prodhuar devijim të qartë të trendit të rezultateve dhe ka dëmtuar rëndë besimin e subjekteve politike dhe kandidatëve. Kur rinumërimi ndërpritet pa kriter, vazhdohet me komuna të tjera dhe humbet gjurmshmëria e vendvotimeve, procesi bëhet i pa besueshëm. KQZ në vend që të mbroj integritetin e votës, po ndryshon rregullat gjatë numërimit dhe rinumërimit, duke u shndërruar nga arbitër i pa anshëm, në palë aktive në deformimin e procesit zgjedhor. Pala ankuese kërkon rikthimin e menjëhershëm, rinumërimin për subjektet politike të komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian, anulimin e votave për subjektet politike nga Komunitetet Ashkali dhe Egjiptian në vendbanimet ku nuk ka pjesëtarë të Komuniteteve të tyre në ato komuna, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë ose Ri përsëritjen e zgjedhjeve në komunat ku ka pjesëtarë të Komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian si në komunat: Pejë, Prizren, Podujevë, Prishtinë, Suharekë, Gjakovë, Mitrovicë Jugore, Istog, Klinë, Lipjan, Shtime, Ferizaj, Fushë Kosovë, Rahovec, dhe Vushtrri. Gjithashtu në ankesë theksohet se rezultati i ngushtë mes koalicionit PAI - PDAK - LPB dhe PSA prej 54 votave ku ne kemi dyshimin tonë që është favorizuar në disa komuna PSA pasi që kjo iniciativë udhëhiqet nga ish Anëtari i KQZ-së, Arton Asllani dhe i afërt me pushtetin besojmë që është manipuluar procesi i rezultateve të zgjedhjeve për vendet e komunitetit Ashkali dhe Egjiptian, dhe se bazuar në Kushtetutën e Kosovës nenit 64 garojmë për vende të garantuar, dhe kemi vendime të Gjykatës Supreme dhe Gj. Kushtetutës që



deputetet e komuniteteve duhet të zgjedhën nga votat legjitime të qytetarëve nga pakicat, andaj pasi kemi një rezultat të ngushtë duhet të anulohen mbi 350 vota të subjektit PSA që kanë marrë në Komuna ku nuk ka pjesëtarë të Komunitetit Ashkali dhe duhet të anulohen mbi 1300 vota të subjekteve nga komuniteti Egjiptian, që kanë marrë në ato komuna që nuk ka pjesëtarë të këtij komuniteti. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës numrin e popullsisë të komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian dhe numrin e votave në çdo komunë për subjektet politike të tyre.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve KQZ, me përgjigjen në ankesë ka theksuar se, procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Krahas fletëvotimeve, në ekran është prezantuar edhe pamja e sistemit elektronik ku figurojnë numrat kandidatëve të cilët regjistrohen në sistem. Pra pretendimet e palës ankuese se KQZ ka ndryshuar metodologjinë e numërimit dhe rinumërimit në mes të procesit, nuk qëndrojnë, sepse KQZ ka vepruar në përputhshmëri të plotë me Rregulloren e lartcekur, si dhe me procedurat e miratuara nga KQZ. Gjithashtu, procesi i rinumërimit është zhvilluar për të gjitha vendvotimet në të gjithë Republikën e Kosovës, duke përfshirë këtu edhe komunat në të cilat janë të përfshira edhe komunitetet të cilat pala i ka përmendur në ankesë. Lidhur me kërkesën e palës ankuese për anulimin e votave të komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian në vendbanimet ku nuk ka pjesëtar të komuniteteve në ato Komuna, KQZ ju njofton se liria dhe e drejta e votës në Republikën e Kosovës janë të garantuara me Kushtetutë dhe me ligjet që rregullojnë proceset zgjedhore, Këto të drejta bazohen në Parimin e barazisë së qytetarëve dhe komuniteteve, që është një nga shtyllat themelore të rendit kushtetues të Kosovës. Pastaj ka theksuar se paragrafi 1 i nenit 45 së Kushtetutës së Republikës së Kosovës thotë: “Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhët, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor”. Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh se: “Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë”. Dispozitat e lartcekura janë të përfshira edhe në nenin 6 paragrafin 1 dhe 2 të LZP-së. Përkatësisht, as Kushtetuta e as Ligji për Zgjedhjet nuk i ndalon votuesit me përkatësi etnike të ndryshme të votojnë në vendvotime, konkretisht Kosova nuk është e ndarë në zona ku zgjedhore votohet sipas përkatësisë etnike, gjithashtu, në bazë të këtyre dispozitave, nuk mund të paragjykohet mënyra e zgjedhjes së votuesit për një subjekt të caktuar politik. Kërkesa e palës ankuese për shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve, nuk qëndron, për shkak se ajo duhet të jetë e bazuar dhe të ketë mbështetje ligjore, e as nuk mund të shpallet fletëvotimi i pavlefshëm në bazë të përkatësisë etnike të votuesit. Rastet e shpalljes së fletëvotimit të pavlefshëm parashihen në paragrafin 2.2 të nenit 16 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, Numërimi Në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit. Gjithashtu, në procedurat e votimit dhe numërimit në vendvotim, të miratuar nga KQZ me datë 04.12.2025, nr. 01/3631/2025 për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, janë paraparë shembujt e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme. Pretendimet e palës ankuese nuk qëndrojnë sepse në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit e as përkatësia etnike e votuesit. Përmbajtja dhe përshkrimi i fletëvotimit parashihet në nenin 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 10/2024 për Fletëvotimet dhe Broshurat.



Paneli, pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, ka gjetur se ankesa është e pabazuar. Paneli ka vlerësuar pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës, e i cili pretendon se ka pasur parregullsi gjatë procesit të numërimit dhe rinumërimit nga KQZ, dhe se rezultati i ngushtë koalicionit PAI - PDAK - LPB dhe PSA prej 54 votave, për të cilin kanë dyshime që është favorizuar në disa komuna PSA dhe është manipuluar procesi i rezultateve të zgjedhjeve për vendet e komunitetit Ashkali dhe Egjiptian, dhe që deputetet e komuniteteve duhet të zgjedhën nga votat legjitime të qytetarëve nga pakicat, me pretendim se pasi kemi një rezultat të ngushtë duhet të anulohen mbi 350 vota të subjektit PSA, që kanë marrë në Komuna ku nuk ka pjesëtarë Komunitetit Ashkali dhe duhet të anulohen mbi 1300 vota të subjekteve nga komuniteti Egjiptian, që kanë marrë në ato komuna që nuk ka pjesëtarë të këtij komuniteti, për Panelin këto pretendime ankimore janë vlerësuar të paqëndrueshme dhe si të tilla janë refuzuar. Nga pretendimet theksuara në ankesë paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pretendon pala ankuese, kjo pasi që ankuesi në ankesën e tij nuk i ka bashkangjitur asnjë provë të vetme dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e tij, dhe se pretendimet e theksuara në ankesë tani për tani mbeten në nivel të supozimit ngase nuk janë argumentuar me fakte dhe prova konkrete. Paneli i ka vlerësuar të paqëndrueshme pretendimet ankimore për faktin se nuk është vërtetuar se ka pasur manipulime të votave, gjegjësisht se në disa komuna është favorizuar PSA, ashtu siç pretendon pala ankuese, kjo pasi që e njëjta pretendimet e saj nuk i ka mbështetur me asnjë provë të vetme, dhe se pritshmëritë e ankuesit nuk nënkupton se automatikisht subjekti politik kishte me marrë vota më shumë. Paneli ka vlerësuar se sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnicitetin e votuesve, përkatësisht të votimit. Andaj për Panelin këto pretendime janë vlerësuar të pabazuara me referencë në nenin 6 par. 2 të LZP-së, ku parashihet se: "Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë", duke mos paragjykuar se si një votues zgjedhë të votojë një subjekt politik të caktuar".

Paneli në rastin konkret i është referuar Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI69/2021 në pikën 196 ku në mënyrë decitive është theksuar se: "... në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë bazë mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaron që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Gjykata rikujton që sipas GJENDJ-së (i) nuk është detyrë e gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve, përfshirë përmes shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë dhe (ii) çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullativa e KQZ-së, në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime". Ndërsa në pikën 198 të këtij aktgjykimi është konstatuar se: "Përfundimisht, Gjykata rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit." Po ashtu paneli ka marrë për bazë dispozitën e nenit 45.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku është paraparë që: "Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve,



gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh që: "Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë." Në rastin konkret, Paneli vlerëson se nuk mund të pranohet një pretendim apo kërkesë e tillë që synon rinumërimin e votave për subjektet politike të komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian, anulimin e votave të dhëna për këto subjekte në vendbanimet ku, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, nuk ka pjesëtarë të këtyre komuniteteve në komunat përkatëse, apo përsëritjen e zgjedhjeve në komunat ku ka pjesëtarë të komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian. Paneli rithekson se, në përputhje me parimet kushtetuese dhe legjislationin në fuqi, vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Si e tillë, ajo nuk mund të anulohet apo të shpallet e pavlefshme mbi bazën e përkatësisë etnike të votuesit. As Ligji dhe as Rregulloret e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk parashohin ndonjë kriter tjetër mbi bazën e të cilit fletëvotimet mund të shpallen të pavlefshme, e aq më pak një kriter që lidhet me përkatësinë etnike të votuesve.

Paneli në fund ka vlerësuar se ankesa e parashtruar nga koalicioni PAI - PDAK - LPB, është e pabazuar pasi që nuk ka bashkangjitur prova bindëse që do të dëshmonte pretendimet ankimore. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse". Andaj, Paneli e refuzoi ankesën pasi që pala ankuese nuk e bëri të besueshme me prova bindëse dhe nuk ka mundur të vërtetoj se është manipuluar procesi i rezultateve të zgjedhjeve për vendet e komunitetit Ashkali dhe Egjiptian, por se theksimet e saj në ankesë janë parashtruar në aspektin deklarativ pa qenë të mbështetura në prova dhe të paargumentuara me fakte, andaj PZAP vendosi që ankesa e ankuesit të refuzohet si e pabazuar, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me refuzimin e ankesës së koalicionit PAI - PDAK - LPB, shkak të parregullsive në shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, respektivisht parregullsive të pretenduara nga ankuesi lidhur me procesin zgjedhor. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se shkeljet e pretenduara për parregullsi të procesit të votimit janë vlerësuar të pabazuara, meqenëse ankuesi në ankesën e paraqitur nuk i është referuar shkeljeve konkrete të dispozitave të procedurës ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, por vetëm çështjeve që kanë të bëjnë me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale, Gjykata Supreme është kufizuar vetëm në trajtimin e këtyre pretendimeve ankimore.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të koalicionit PAI - PDAK - LPB, përkitazi me rezultatet e përgjithshme të zgjedhjeve të parakohshme, respektivisht parregullsitë e procesit zgjedhor, për vendet e komunitetit Ashkali dhe Egjiptian, respektivisht rezultatin jashtëzakonisht të ngushtë (diferencë prej 54 votash), duke kërkuar që bëhet verifikimi procedural dhe rinumërimi për shkak të parregullsive dhe ndryshimeve arbitrare në metodologjinë e numërimit të votave, mirëpo këto pretendime dhe të



tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme. Kjo për faktin se PZAP, me rastin e refuzimit të ankesës së koalicionit PAI - PDAK - LPB, si në vendimin e atakuar, me të drejtë ka vlerësuar se nuk ankuesi nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi në komunat: Pejë, Prizren, Podujevë, Prishtinë, Suharekë, Gjakovë, Mitrovicë Jugore, Istog, Klinë, Lipjan, Shtime, Ferizaj, Fushë Kosovë, Rahovec, dhe Vushtrri, dhe atë në mungesë të provave të ofruara nga ana e parashtruesit të ankesës.

Nga kjo rrjedh se është i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP, se pretendimet e koalicionit PAI - PDAK - LPB për parregullsi gjatë procesit të numërimit dhe rinumërimit nga KQZ, me arsye të rezultatit të ngushtë të koalicionit PAI - PDAK - LPB dhe PSA prej 54 votave, për të cilin kanë dyshime që është favorizuar në disa komuna PSA dhe është manipuluar procesi i rezultateve të zgjedhjeve për vendet e komunitetit Ashkali dhe Egjiptian, janë vlerësuar të paqëndrueshme, kjo pasi që ankuesi me asnjë provë të vetme nuk ka arritur të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi, respektivisht manipulime të votave, gjegjësisht se në disa komuna është favorizuar PSA, ashtu siç pretendon pala ankuese. Për më tepër me të drejtë është theksuar se sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnicitetin e votuesve, përkatësisht të votimit. Nga kjo rezulton i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP-it, se marrja e deklaratave të tilla e cenon procesin e votimit dhe të drejtën e fshehtësisë së votës të paraparë sipas dispozitave ligjore nga neni 6 paragrafi 2 i LZP-së, që parasheh se: “Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë”, duke mos paragjykuar se si një votues zgjedhë të votojë një subjekt politik të caktuar.

Pretendimet ankimore lidhur me parregullsitë që i referohen hetimit të procesit zgjedhor dhe zbatimit selektiv të Aktgjykimit KI69/2021 të Gjykatës Kushtetuese nga Gjykata Supreme janë vlerësuar të pabazuara, kjo për faktin se në këtë rast nuk mjafton që pala ankuese vetëm ti referohet parregullsisë së procesit të votimit, dhe në anën tjetër të mos paraqes asnjë provë lidhur me vërtetimin e parregullsive të pretenduara. Gjykata Supreme vlerëson se Paneli, pikërisht duke u mbështetur në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KI69/2021, me të drejtë ka vlerësuar se, në sistemin zgjedhor të Republikës së Kosovës nuk ekziston bazë ligjore për shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve apo për rinumërimin e tyre mbi bazën e supozimeve lidhur me përkatësinë etnike të votuesve. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet apo shpallet e pavlefshme mbi kritere etnike. Kjo mbështetet edhe në nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregulloret përkatëse të KQZ-së, të cilat nuk parashohin ndonjë kriter të tillë për shpalljen e pavlefshmërisë së fletëvotimeve. Ndërsa në anën tjetër ankuesi nuk ka arritur të dëshmoj se në këtë rast ka pasur parregullsi, apo mënyrë arbitrare të metodologjisë së numërimit të votave, të cilat kanë devijuar vullnetin e votuesit, duke ndikuar kështu në cenimin e demokracisë së brendshme zgjedhore, për rrjedhojë, kërkesat për rinumërim, anulim të votave apo përsëritje të zgjedhjeve mbi këtë bazë vlerësohen si të pabazuara.

Me nenin 117 të Ligjit Nr.08/1-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, janë përcaktuar [Procedurat e PZAP-së], ku me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: 13.



Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse, ndërsa, sipas nenit 118 [Vendimet], të këtij ligji përcaktohet se: “1. PZAP-ja pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”. Mbi këtë bazë kjo gjykatë i ka vlerësuar të pabazuara edhe pretendimet lidhur me atë se vendimi i PZAP ka keqinterpretuar objektin dhe përmbajtjen e ankesës së ankuesit mbi bazën e përkatësisë etnike të votuesve, kjo për faktin se duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar nga PZAP, dhe dispozitave të lartcekura, vlerëson se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, nga çka rezulton se vendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe me Rregulloren Nr.14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), dhe në mungesë të provave të qëndrueshme ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara. Kjo për faktin se si të tilla nuk dëshmuar se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakte të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

AA.nr.7/2026, datë 09.02.2026

Kryetari i kolegjit,
Faton Bajrami



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik
[Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA
KESHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS / SUBSIDIARY COURT OF KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

SEKRETARATI I KESHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Sheji i shkresës:
Oznaka spiset:

AA-7/2026

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOKUMENTI DOSTAVLJANJE

PRIZRIP - PRIZRIP

1. Pasi marrësi i cili me llogarimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e kështë dështë të bëhet dorëzimi i sa pas llogarit të kështë dështë me shkruar që për shkak të dorëzimit të gjendur në kohën e caktuar në bancesh apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë; anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërsesë, gjatë, personit që punon po në të vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zalecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni pošto ostavljenog pismenog obavještenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stani radnom mestu, dostava je izvršena: odaslom članu domaćin. Primaca nastojnika zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primacem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u ja në bancesh në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në dorën e bancesh ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njegov domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stani - radnom mestu primaca (približno na vrata stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Me: 201 në ora u cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes
Razlog odbijanja prijma:

Nënshkrimi i dorëzuesit - popis dostavljaoca

Nënshkrimi i dorëzuesit - popis dostavljaoca

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

ALTGALICIN
09.02.2026

Numri i shlojcave: 2
broj priloga

Vetëto se mora shkresën e lartëpërmendur
më (me fjalë)
Povdujemo prijem gorenaavegenog pisma
(i slovima)

Prizri 03.02.2026

(Nënshkrimi i marrësit ose i anij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Popis primaca ili licu koje je
pismeno primilo u zamenu)

Në rasti se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpise, potpisuje ga dostiljac, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.